



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 6.735 / 13 prot.

Divjakë, më 17.07.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 48, datë 17.07.2025

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 70, DATË 24.12.2024, "PËR
MIRATIMIN E NIVELEVE TË PAGAVE TË BASHKISË DIVJAKË, NJËSIVE
ADMINISTRATIVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARTËSI PËR VITIN 2025",
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54, gërma "ç", të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar me VKM-në nr. 503, datë 01.08.2024, i propozohet Këshillit të Bashkisë Divjakë që në mbledhjen e datës 25.07.2025:

Të miratojë:

1. Ndryshimin e klasifikimit të nivelit të arsimit për pozicionin 'Inspektor Pyjor', pranë Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Bujqësisë, Mjedisit, Veterinarisë dhe Pyjeve, Bashkia Divjakë, nga arsim "i lartë" në arsim "të mesëm".

2. Si rezultat i ndryshimit të nivelit të arsimit, pozicioni i mësipërm, i klasifikuar më parë në klasën IV-2, do të riklasifikohet, duke u trajtuar sipas pikës 11 të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, i ndryshuar me VKM nr. 503, datë 01.08.2024.
3. Paga e pozicionit nuk ndryshon dhe mbetet 47,000 (dyzet e shtatë mijë) lekë, pasi është në përputhje me kufijtë e pagës për kategorinë e rishikuar.
4. Efektet e këtij ndryshimi propozohet të fillojnë të zbatohen që nga data 01.08.2025.

Përgjegjës i Sektorit Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme

Atalanta Simaku

Përgjegjës i Sektorit Juridik, Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit Aseteve

Andi Bullari

Drejtor i Financës dhe Buxhetit

Xheladin Brahkola

**KRYETARI
JOSIF GORREA**

